

30 VJETORI I THEMELIMIT TË XHAMISË “Hëna e Re” në Kreuzlingen-ZVICËR

- I nderuari imam i xhamisë Mr. Rejhan ef. Neziri, e nderuara kryesi e xhamisë në krye me kryetarin Besir Halili.
- i nderuari kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër hfz. Mehas ef. Alia,
- i nderuari i përfaqësues i Bashkësisë islame të Republikës së Kosovës (miku ynë) drejtor Ekrem ef. Simnica,
- të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe kantonale të Zvicrës
- të nderuar hoqxhallarë, imamlerë të rretheve të ndryshme nga Zvicra,
- të nderuar mysafirë, shumë të respektuara motra dhe vëllezër:

Kam nderin që në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht në emër të kryetarit të saj, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai, në emër të gjithë besimtarëve musliman të RMV-së si dhe në emrin tim personal t'iu përshëndes me përshëndetjen e islame Es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu/ Gjithnjë paqja dhe begatitë e Allahut Madhëriplotë qofshin me ju!

Me kënaqësi të veçantë pranuar ftesën që të marrim pjesë në manifestimin kulturor e fetar kushtuar 30 vjetorit të themelimit të xhamisë “Hëna e Re” këtu në Kreuzlingen, me qëllim që të ndajmë bashkërisht me ju gëzimin që ndërlidhet me një histori të sukseseve të mëdha që janë arritur gjatë tri dekadave.

Ne tani në këto momente, bashkërisht po përjetojmë çaste të bukura e të lumtura jo vetëm për xhematin e mrekullueshëm të kësaj faltoreje shumë të rëndësishme e me vlera shumë të mëdha, por edhe me gjerë për të gjithë besimtarët musliman të Zvicrës si dhe për ne si BFI e RMV-së. Janë momente të këndshme ku përkujtojmë një histori të aktiviteteve dhe sukseseve multidimensionale. Ky eveniment neve na përkujton dhe freskon vetëdijen tonë se besimtarët tanë musliman janë të vetëdijshëm që jeta fetare mund të organizohet dhe zhvillohet në mënyrën më të denjë e më të mrekullueshme vetëm në mënyrë institucionale ashtu siç veproi edhe i Dërguari i Allahut Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi a.s. posa arriti në Medinen e ndritur.

Xhamia «Hëna e Re» ashtu siç përkon edhe me emrin e saj që përpos simbolizimit të Fesë Islame gjithashtu ky emër nënkupton rigjallërimin, përparimin, zhvillimin, lumturinë e gëzimin, andaj kjo faltore në krye me teologët, hoqxhallarët vizionar siç është edhe aktualisht Mr. Rejhan ef. Neziri, gjithnjë ka sjellë një frymë të re, qasje dhe shpjegime të reja me urtësi dhe thellësi fetare po do të thoja edhe kombëtare e patriotike që efendilerët e kësaj xhamie nëpërmjet ligjëratave të tyre kanë lundruar thellë në aktualitet e kohës dhe hapësirës ku veprojnë, kohë pas kohe edhe përtej saj duke depërtuar me idetë dhe konceptet e tyre të shkruara siç janë një shembull i bukur veprat e botuara të Rejhan efendiut në gjuhën shqipe dhe gjermane, si dhe vrulli i aktiviteteve edhe jashtë mureve të xhamisë, «Hënën e Re» e kanë bërë një faltore të mirënjohur në të gjithë truallin evropian. Të gjitha këto janë gjurmë të pashlyera në historinë e mendimit fetarë dhe kombëtarë në Kreuzlingen, krenari për ne në vendlindje, si dhe në përgjithësi në diasporë.

Të nderuar të pranishëm; Padyshim që Xhamia është një vatër që shpirtërisht na bashkon, na afron, na pajton madje edhe na ushqen shpirtin dhe zemrën tonë. Ndërsa

me çka është e mbushur zemra ajo derdhet dhe shfaqet në të folur, në art, në lëvizje dhe veprim.

Është bukuri e veçantë kur mësimi i xhamisë reflektohet kudo në jetën e përditshme. Xhamia është vendi ku adhurimi i kushtohet vetëm Allahut Madhëriplotë, është vendi i paqes, dashurisë, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Andaj kur ne shënojmë një përvjetorë të këtillë do të thotë përkujtojmë një histori të bujshme të aktiviteteve të shumëllojshme të Shtëpisë së Zotit. Nëpërmjet kulturës së përfituar nga edukimi në Xhami besimtarët edhe më tej vazhdojnë të ngrenë lartë ndërgjegjshmërinë dhe vetëdijen e përgjegjësisë. Adhurimi që është kryefjala e xhamisë është një thesar që ndërton dhe forcon lidhjen tonë me All-llahun xh.sh. ndërsa mirësjellja, vepërmirësia që është fryt i ibadetit/adhurimit është një thesar që ndërton lidhjet tona me njerëzit dhe krijesat e tjera.

Të nderuar vëllezër e motra; E kemi përmendur edhe në raste tjera këtu në Zvicër faktin se, një bahçe që ka shumë lloje të trëndafilave gjithnjë është më e bukur nga një bahçe që ka vetëm një lloj trëndafil. Zvicëra dhe shoqëria zvicerane i përngjanë një bahçeje me trëndafila të ngjyrave, gjuhëve dhe kulturave të ndryshme por që kanë një qëllim të përbashkët kultivimin e aromës njerëzore, kulturore dhe qytetëruese. Jam i bindur që edhe Xhamia Hëna e Re këtu në Kreuzlingen është një trëndafil në skajin e trëndafilishtes Zvicër që shpërndanë aromë të këndshme të cilën e shijojnë jo vetëm besimtarët musliman por e gjithë shoqëria e këtij vendi. Padyshim që për këtë histori suksesesh të kësaj qendre, për të gjitha këto punë të mëdha, ka shumë njerëz e shumë faktorë që janë meritore. E gjithë kjo është vështirë të realizohet pa pasur një promotorë që do i udhëheqë këto punë të mbara, e në rastin konkret është veprimtari i shquar, miku ynë, i nderuari Mr. Rejhan ef. Neziri të cilit në emër të BFI-së si dhe në emrin tim personal i shprehim mirënjohjet tona më të thella dhe i dëshirojmë jetë të gjatë e shëndet që edhe më tej shoqërisë sonë besimtare t'i sjellë suksese e bereqet. Gjithashtu falënderojmë edhe anëtarët këshillit të xhamisë të cilët japin një kontribut të çmueshëm në mbarëvajtjen e jetës fetare. Në mënyrë të veçantë shprehim falënderimet dhe mirënjohjet tona për autoritetet e shtetit Zviceran për këto mundësi të ofruara ndaj besimtarëve musliman dhe shqiptarëve në përgjithësi.

Vëllezër të dashur, dhëntë Zoti që Xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen si dhe të gjitha xhamitë tjera ku do që janë, të vazhdojnë t'i kultivojnë vlerat dhe urtësitë islame në mënyrën më të denjë më të kulturuar duke mbjellë paqe, mirëkuptim dhe tolerancë në mesin e besimtarëve musliman si dhe në mesin e njerëzve në përgjithësi.

Gjithnjë qofshi në shërbim të paqes, mirësisë dhe respektit ndaj krijesave për hir të Krijuesit Zoti i bekoftë xhamitë dhe xhematet tona.

Ve selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu!

28.01.2028 Kreuzlingen

Dr. Selver Xhermaili, Drejtor në sektorin për diasporë pran BFI-RMV